



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 482/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e Gani Krasniqi nga Malisheva, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.482/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga Gani Krasniqi nga Malisheva, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Gani Krasniqi, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.482/2019, me të cilën pretendon se me datë 06.10.2019, ditën e zgjedhjeve shume individ të cilit ishin të angazhuar direkt në procesin e zgjedhjeve, përkatësisht komisionerët kanë pasur informacione për ecurinë e votimit, ne teren më kanë njoftuar për një gjendje me entuziaste nga ajo që më rezultojë me pas, pra shumë më shumë vota kisha pasur nëpër vendvotime se nga ato që janë publikuar dje nga KQZ-ja me datë 07.11.2019. Nga kjo rezulton se votat e mija janë manipuluar dhe keqpërdorur nga komisionerët në kundërshtim me LPZ-në dhe rregullat zgjedhore. Në fund parashtruesi i apelit kërkon të rinumërohen të gjitha vendvotimet në Kosovë. Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vlefshme lidhur me pretendimet e tij.

Në përgjigje në apel të datës 09.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kaloj (procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose

subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të te gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në, që vendotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete lidhur me atë se çfarë është pretenduar në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtuar nga Gani Krasniqi i subjektit politik LVV, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.482/2019 më datën 09.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Fhaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.